



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Plus Trade" Sh.P.K. të datës 22.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Plus Trade" Sh.P.K. të datës 22.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Plus Trade" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 22.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik" me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim:

Pretendimi i parë – për lot 2 tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim jonormalisht të ultë si dhe nuk ka dorëzuar CV për punonjësit sipas DT.

Pretendimi i dytë – për lot 3 tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim jonormalisht të ultë si dhe nuk ka plotësuar aneksin 7 sipas DT.

Pretendimi i tretë – për lot 4 tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët.

Lidhur me pikat e pretendimeve ankimore për çmime jonormalisht të ulëta nga tenderuesit e rekomanduar në lot 2, lot 3 dhe lot 4 është gjetur se në të tri lotet ekzistojnë më shumë se tre ofertues ndërsa ofertat e tenderuesve të rekomanduar janë dukshëm më të ulëta sesa nën 30% e mesatarës së të gjitha çmimeve të ofertuara si dhe dukshëm nën 10% të çmimeve të dyta më të ulëta pas tenderuesve të rekomanduar.

Përmes nenit 41.3 të RRPP është përcaktuar se “Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme : i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”. Në këtë mënyrë është gjetur se çmimet me të cilat kanë ofertuar tenderuesit e rekomanduar në lot 2, 3 dhe 4 janë jonomalisht të ulëta ndërsa komisioni vlerësues nuk ka zbatuar nenin 41 të RRPP.

Sa i përket pjesës së pretendimit të parë dhe të dytë ankimor lidhur me kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional, komisioni duhet të verifikoj nëse në lot 2 është plotësuar kërkesa për punonjësit e OE si dhe për lot 3 nëse është plotësuar aneksi 7 sikurse është kërkuar në DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.07.2024

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.